



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 848/5 Prot

Tiranë, më 10/5/2022

VENDIM

Nr. 13, datë 10.5.2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, Qendra Kujri, përfaqësuar nga znj. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 848 Prot., datë 21.04.2022, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në cilësinë e kërkueses, ankuesja, nëpërmjet shkresës datë 06.04.2022, Qendra Kujri, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion dokumentacioni lidhur me vendimin nr.16, datë 03.10.2018 të Këshillit Kombëtar të Territorit në të cilin është vendosur miratimi i lejes së ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i HEC-it Sekë dhe Zais, në pellgun ujëmbledhës të lumit të Urakës dhe Zallit të Melthit”, si:

- *Relacioni teknik për projektin në fjalë, akt kolaudimi projekti, relacioni elektrik dhe raport monitorimi të funksionimit të këtyre heceve.*

Autoriteti Publik, me shkresën nr. 1819 Prot., datë 19.04.2022 i ka kthyer përgjigje ankueses duke sqaruar se: “...Referuar VKM-së nr. 547, datë 09.08.2006, i ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (në vijim, “AKBN”) ka objekt të veprimtarisë

zhvillimin, mbikqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse dhe monitorimin e postshfrytëzimit të tyre, në sektorin minerar, hidrokarbur dhe energjitik. Neni 27 i Kontratës së Koncesionit, Konfidencialiteti: Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentet dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate. Referuar VKM-së dhe nenit të sipërcituar, AKBN nuk është institucion i autorizuar në dhënien e informacionit të kërkuar.”

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesja pretendon se: “Autoriteti Publik, ka refuzuar të vendosë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar me pretendimin se është dokument konfidencial. Këtë refuzim e mbështet në nenin 27 të kontratës së nënshkruar, duke ju referuar parimit të konfidencialitetit i cili u jep të drejtë vetëm palëve të kenë dokumentacionin zyrtar dhe i ndalon që ta shpërndajnë tek persona të tretë.

Ky pretendim i ngritur nga Autoriteti Publik për të refuzuar vënien në dispozicion të dokumentacionit vjen në kundërshtim të hapur me nenin 7 pikën (ë) të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, një ndër kategoritë e informacioneve të cilat duhet të vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë paraprake për informacion është edhe: “ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për Ilogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

Pra informacioni i kërkuar, është një informacion që duhet të ishte bërë publik pa kërkesë. Si rezultat, pretendimet e ngritura për refuzim të dhënies së informacionit nuk qëndrojnë dhe janë në kundërshtim me ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Së dyti, neni 17 i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, parashikon se: “I. E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: a) të drejtën për një jetë private; b) sekretin tregtar; c) të drejtën e autorit; ç) patentat. Kufizimi i së drejtës së informimit, për shkak të interesave të parashikuar në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të kësaj pike, nuk zbatohet kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për dhënien e informacionit përkatës ose kur në momentin e dhënies së informacionit ai është konsideruar autoritet publik në bazë të parashikimeve të këtij ligji. Pavarësisht nga sa parashikohet në këtë pikë, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij.

Në analizë të parashikimit ligjor, informacioni i kërkuar, pra relacionin teknik, akt kolaudimi, projekti, relacioni elektrik dhe raportet e monitorimit nuk çenojnë asnjë prej interesave të mësipërme: as jetën private, as sekretin tregtar, as të drejtën e autorit dhe

*as patentat. Kontratat e koncensionit, janë kontrata publike të cilat kanë për qëllim kryerjen e punëve apo shërbimeve ku subjekti shpërblimin për realizimin e projektit e merr nga e drejta për të shfrytëzuar veprën apo shërbimin. Në çdo rast bëhet fjalë për një kontratë me interes publik dhe si e tillë, procedura e lidhjes, përmbajtja, mënyra e përmbushjes së saj, bëjnë pjesë tek informacionet publike në kuptim të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Kontratat koncensionare ofrojnë shërbime apo vepra publike, si të tilla është në të drejtën e publikut që të ketë të gjithë informacionin e nevojshëm për mënyrën e përmbushjes, apo mospërmbushjes së këtyre kontratave.”*

Ndodhur në këto kushte, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ankuesja i është drejtuar Zyrës së Komisionerit duke kërkuar ushtrimin e kompetencave, që i njej ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e dokumentacionit të cituar në kërkesën për informacion.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, me Urdhrin nr. 65, datë 22.04.2022, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik duke filluar nga data 28.04.2022.

Pranë Autoritetit Publik u depozitua urdhri i inspektimit administrativ i cili u protokollua me nr. 1922 Prot., datë 26.04.2022.

Gjatë inspektimit, në mungesë të koordinatores për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik u kontaktua me Drejtorinë e Monitorimit të Hidrocentraleve, e cila ka trajtuar kërkesën për informacion, për të konfirmuar nëse dokumentacioni i kërkuar disponohet nga Autoriteti Publik, si dhe për të administruar qëndrimin përfundimtar në lidhje me çështjen objekt inspektimi.

Përfaqësuesi i Autoritetit Publik sqaroi se: *“Kërkesa e Qendrës Kujri është depozituar nëpërmjet e-mail-it datë 06.04.2022 në adresë të koordinatorit për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik. Në vijim koordinatori e ka përcjellë këtë kërkesë për trajtim pranë Drejtorisë së Monitorimit të Hidrocentraleve. Kjo drejtori, pas trajtimit të kërkesës, ka përpiluar përgjigjen të cilën e ka përcjellë në adresë të koordinatorit me e-mail-in datë 11.04.2022. Gjithashtu, janë bërë me dije se kjo përgjigje i është në dispozicion kërkuases me shkresën nr. 1819 Prot., datë 19.04.2022.*

*Nga dokumentacioni i kërkuar disponohet vetëm relacioni teknik për projektin në fjalë, relacioni elektrik dhe raport monitorimi i funksionimit të këtyre heceve, ky i fundit i hartuar nga AKBN, i cili mund të vendoset në dispozicion të ankueses. Ndërkohë, akt*

*kolaudimi i këtij projekti nuk disponohet nga Autoriteti Publik. Lidhur me vendosjen në dispozicion të relacionit teknik dhe relacioni elektrik për projektin në fjalë, rikonfirmohet qëndrimi i mbajtur në shkresën nr. 1819 Prot., datë 19.04.2022. Ky qëndrim, vjen si pasojë e marrjes së masave paraprake në rast të një procesi të mundshëm gjyqësor nga ana e palës koncesionare. Gjithsesi, theksohet se, Autoriteti Publik është i hapur për të bashkëpunuar me Zyrën e Komisionerit nëse vendoset urdhërimi i dhënies së këtij informacioni”.*

Në vijim, Autoriteti Publik, me e-mail-in datë 29.04.2022, ka informuar ankuesen se: *“...në zbatim të Neni 27 të Kontratës së Koncesionit (Konfidencialiteti), bashkëlidhur po vendosin në dispozicion Raportin e fundit të Monitorimit, të hartuar nga AKBN për Hec-et Sekë dhe Zais, në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021, duke kufizuar dhënien e informacionit që përmban të dhëna teknike”.*

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesja ka vijuar me ankimin e regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 848/3., datë 05.05.2022 duke kërkuar vendosjen në dispozicion të relacionit teknik, akt kolaudimit dhe relacionit për projektin “Ndërtimi i HEC-it Sekë dhe Zais, në pellgun ujëmbledhës të lumit të Urakës dhe Zallit të Melhit”, pasi nga Autoriteti Publik i është vendosur në dispozicion vetëm Raporti i Monitorimit”.

Në përfundim, pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga ana e Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Konkretisht argumenti i Autoritetit Publik se: *“Referuar VKM-së nr. 547, datë 09.08.2006, i ndryshuar dhe Neni 27 të Kontratës së Koncesionit, AKBN nuk është institucion i autorizuar në dhënien e informacionit të kërkuar”,* nuk qëndron.

Në shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.* Në kuptim të këtij parashikimi, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”*

Gjithashtu, konstatohet se Autoritetit Publik, citon nenin 27 të Kontratës së Koncesionit që lidhet me me konfidencialitetin, por nuk ka argumentuar saktësisht se si dhënia e këtij informacioni mund të çënojë apo shkelë këto parime.

Gjatë hetimit administrativ Autoriteti Publik nuk provoi në asnjë moment, se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështetet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar. Pasi është ky nen, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Për rrjedhojë, në mungesë të një dispozite të posaçme ligjore për të legjitimuar diskrecionin e Autoritetit Publik për të kufizuar të drejtën për informim të publikut, nëpërmjet parashikimeve të klauzolave kufizuese dhe përjashtuese të përcaktuar në këtë kontratë, Komisioneri e gjen qëndrimin e mbajtur nga Autoriteti Publik në kundërshtim me LDI.

Ndërkohë, nga verifikimi i legjislacionit të posaçëm që rregullon procedurat e koncesionit nuk rezulton që kontrata e lidhur me subjektin privat apo informacioni objekt kërkimi, të parashikohet si informacion konfidencial, për të autorizuar në këtë mënyrë lidhjen e një kontrate të tillë dhe legjitimimin e Autoritetit Publik për kufizimin e të drejtës për informim të qytetarëve.

Gjithashtu, Komisioneri ka konsoliduar qëndrimin e tij lidhur me kontratat e koncensioneve publike, si dhe dokumentacionin pjesë përbërëse të tyre, duke i konsideruar ato informacion publik për sa kohë që nuk ka parashikim të posaçëm ligjor të ndryshëm nga parashikimet e LDI.

Në pikën 6 të nenin 17 të LDI, parashikohet se: *“.....Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”*. Bazuar në këtë parashikim, Autoriteti Publik duhet të kishte vlerësuar individualisht çdo pikë të kërkesës për informacion, duke provuar dhe argumentuar mbi cilën pikë të nenit 17 bazohet kufizimi i informacionit, vlerësim i cili nuk rezulton të jetë bërë. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se Autoriteti Publik nuk mund të bazojë kufizimin e një të drejte kushtetuese, vetëm mbi argumentin se *kontrata dhe dokumentet vijuese mbrohen nga parimi i konfidencialitetit*.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, informacioni i kërkuar në kërkesën për informacion datë 06.04.2022, konkretisht kërkesa që lidhet me *“relacionin teknik dhe relacionin elektrik për projektin “Ndërtimi i HEC-it Sekë dhe Zais, në pellgun ujëmbledhës të lumit të Urakës dhe Zallit të Melthit”*, përmbush në parim kriteret e pikës 2, të nenit 2, të LDI, në të cilën parashikohet se: *“informacion publik” është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik”*.

Në këto kushte, Autoriteti Publik duhet ta vendosi atë në dispozicion të kërkuesit në përputhje me nenin 17 të ligjit të sipërcituar.

Lidhur me kërkimin që lidhet me “*akt kolaudimin e këtij projekti*”, Komisioneri konstaton se, gjatë inspektimit përfaqësuesi i Autoritetit Publik ka deklaruar se ky dokumentacion nuk zotërohet nga ky autoritet, në këto kushte ky kërkim, nuk përmbush kriteret e pikës 2 të nenit 2 të LDI dhe rrjedhimisht duhet rrëzuar.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforsimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. E drejta për informim duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre është në interesin publik.

E drejta për informim, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e cila ka për qëllim t’i garantojë publikut njohjen me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë.

Në pikën 2 të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: “*Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore...*”.

Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: “*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*”.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar,

## **V E N D O S A:**

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës nr. 848 Prot., datë 21.04.2022, nga Qendra Kujri, përfaqësuar nga znj. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik “Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore”, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion datë 06.04.2022, duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, konkretisht: (*Relacioni teknik dhe relacioni elektrik për projektin “Ndërtimi i HEC-it Sekë dhe Zais, në pellgun ujëmbledhës të lumit të Urakës dhe Zallit të Melthit*”), brenda datës 17 . 5 .2022.

3. Rrëzimin e ankesës për dokumentacionin e kërkuar lidhur me “akt kolaudimin e projektit “Ndërtimi i HEC-it Sekë dhe Zais, në pellgun ujëmbledhës të lumit të Urakës dhe Zallit të Melthit””, sipas kërkesës për informacion datë 06.04.2022.
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
5. Ky vendim u shpall sot në datë 10 . 5 .2022.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

